



Datë: 07.07.2025

Numër Protokolli: 4914/2025

A.nr.733/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.733/2025 të datës 25.04.2025 të parashtruar nga ankuesi G.H, kundër Agjencisë Pyjore të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.733/2025 e datës 25.04.2025, e parashtruar nga ankuesi G.H.

II. Mbetët në fuqi Njoftimi me numër protokolli 1211, i datës 23.04.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës, lidhur me rezultatet përfundimtare të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016773, për pozitën “Asistent Administrativ”.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, G.H (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 25.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016773, për pozitën e punës “Asistent Administrativ”, të shpallur më datë 19.02.2025, nga Agjencia Pyjore e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Pyjore e Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 09.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimi të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 3882/2025 të datës 09.06.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2749/2025, të parashtruar nga ankuesi më datë 25.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi; Njoftimin me numër protokolli 1211 të datës 23.04.2025; Dokument identifikimi; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë; Shkresën me numër protokolli 482 të datës 19.02.2025; Konkursin me numër reference RN00016773 të datës 19.02.2025; Vendimin për emërimin e Komisionit të Pranimet me numër protokolli 946 të datës 02.04.2025, si dhe Akt emërimet; Njoftimin me numër protokolli 975 të datës 03.04.2025; Pyetjet e testit me shkrim; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe refuzuar; Aplikacionin e kandidates Sh.A, të datës 20.03.2025, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës; Aplikacionin e ankuesit, të datës 23.02.2025, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës; Pyetjet e intervistës dhe Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e **pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Agjencia Pyjore e Kosovës më datë 19.02.2025, ka shpallë Konkursin me numër reference RN00016773, për pozitën “*Asistent Administrativ*”, me afat aplikimi nga data 20.02.2025 deri më datën 21.03.2025.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 65 kandidatë, ku prej tyre 64 kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesin, i cili duke qenë se ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit ka arritur gjithsejtë 78.8 pikë të përgjithshëm nga kjo procedurë rekrutimi, që sipas Njoftimit me numër protokolli 1211 të datës 23.04.2025, rezulton se i njëjti është renditur i dyti pas kandidates Sh. A, e cila ka arritur gjithsejtë 80.02 pikë, nga procedura e rekrutimit me numër reference RN00016773 .

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se procedura përkatëse e rekrutimit është zhvilluar përmes shkëljes së parimeve të transparencës, barazisë dhe meritokracisë, duke theksuar ndër të tjera se në intervistën me gojë nga totali prej 5 pyetjeve më janë parashtruar 6 pyetje, përgatitja profesionale e tij e bënë kandidat më adekuat për këtë pozitë, dallimi në mes vlerësimit të testit me shkrim dhe intervistës shton dyshime mbi mungesën e objektivit, andaj i njëjti pas shqyrtimit të procedurës së rekrutimit kërkon përzgjedhje në mënyrë që procesi të jetë i drejtë dhe në përputhje me ligjin.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, e duke u bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016773, për pozitën “*Asistent Administrativ*”-Klasa Profesional 3, dhe ka konstatuar se kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë këto: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e shkollës së mesme apo ekuivalente me të;* **Kërkesat specifike:** *Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuq.* **Përvoja e punës e kërkuar:** *Nuk kërkohet.*

Andaj, nga analizimi i shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 39 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe nenit 10 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjete (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimit i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimit mund të parashtrojnë edhe nën pyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitë e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të gjithë anëtarëve; konstaton se ankuesi ka plotësuar kërkesat ligjore të përcaktuara me shpalljen e konkurseve përkatëse; Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa qëndrueshme, ngase i njëjti duke qenë se ka arritur 60 pikë nga testi me shkrim, i është nënshtruar vlerësimit të intervistës me gojë nga e cila ka arritur 18.8 pikë nga 30 pikë maksimale, ndërsa tek fusha e jetëshkrimit (arsimimi, përvoja e punës dhe trajnimet) i njëjti duke qenë se plotëson kërkesat e përgjithshme formale rezulton se është vlerësuar me pikë maksimale nga Komisioni i Pranimit, ndërsa vlerësimi i përgjigjeve sipas legjislacionit në fuqi për procedurat e pranimit në shërbimin civil është në diskrecion të Komisionit të Pranimit, ashtu që sipas shkresave të bashkangjitura nga organi i punësimit rezulton se Komisioni ka përpiluar 5 pyetje të përgjithshme për vlerësimin e intervistës me gojë, si rrjedhojë ankuesi me asnjë dëshmi apo provë relevante nuk ka mundur të mbështet pretendimin e tij se procedura përkatëse e rekrutimit është zhvilluar përmes shkëlqes së parimeve të transparencës, barazisë dhe meritokracisë, ngase i njëjti sikurse edhe kandidatja me më së shumti pikë të arritura i janë nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit, mirëpo që kandidatja Sh.A, në përfundim të procedurës ka arritur gjithsejtë 80.2 pikë (53.8 nga testi me shkrim dhe 26.4 nga intervista me gojë), si dhe po ashtu e njëjta i plotëson kërkesat e arsimore si më sipër, respektivisht e njëjta posedon Diplomën me numër protokolli 121/6 të datës 26.08.2002, për kryerjen e Shkollës së Mesme të Përgjithshme-Gjimnazi “Kuvendi i Arbërit” në Ferizaj; Diplomën me Nr.1002/17 të datës 28.08.2017, të lëshuar nga Kolegji Unversium, me të cilën dëshmohet se e njëjta me datë 29.06.2017 ka mbaruar studimet në Programin Biznes dhe Menaxhment, duke fituar gradën Bachelor i Arteve në Biznes dhe Menaxhment me Specializim në Banka dhe Financa; si po ashtu e njëjta posedon dhe Diplomën me Nr.553 të lëshuar me datë 16.11.2018, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, për përfundimin e studimeve në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, gjegjësisht në Departamentin e Menaxhmentit Industrial, duke fituar gradën Bachelor i Menaxhmentit Industrial.

Kolegji i Këshillit, duke bazuar në rrethanat dhe konstatimet si më sipër, konstaton se Komisioni i Pranimit dhe rrjedhimisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të

Kosovës, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit me numër protokolli 1211 të datës 23.04.2025, lidhur me rezultatet përfundimtare të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016773, për pozitën “Asistent Administrativ”, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimit me numër protokolli 1211 të datës 23.04.2025, lidhur me rezultatet përfundimtare të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016773, për pozitën “Asistent Administrativ” në Agjencinë Pyjore të Kosovës, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.733/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit G.H;*
- *Udhëheqëses së Njësië për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës; si dhe,*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*